



AGJENCIA E KOSOVËS PËR AKREDITIM
KOSOVO ACCREDITATION AGENCY
AGENCIJA ZA AKREDITOVANJE KOSOVA

Nr. 62/16 Dt. 27.01.2016

Në mbështetje të nenit 4,21,22 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189), neni 7 (pika 2.3 dhe 4) neni 15 (pika 1, 2 dhe 3) të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037), Udhëzimit Administrativ për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë (Nr. 25/2012), Udhëzimit Administrativ për Themelimin e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës (Nr. 11/2004), Udhëzimit Administrativ mbi Kriteret dhe Procedurat për Akreditimin e Shkollave të Larta Profesionale dhe Shkollave të Larta Teknike në Republikën e Kosovës (Nr. 12/2009), dhe Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013), nenin 108 të Ligjit mbi Procedurën Administrative, nr. 02/L-28, datë 22.07.2005, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë, në mbledhjen 39-të të mbajtur më 21 janar 2016, mori:

V E N D I M

Për korrigjimin (ndryshimin) e vendimit të KSHC-së nr: 641/15 data: 13.07.2015

- I. Aprovohet kërkesa nr.34/16, datë 19.01.2016 e BPrAL Kolegji i Shkencave Mjekësore "Rezonanca" për përmirësimin e gradave shkencore.
- II. Korrigjohet (përmirësohet) vendimi i KSHC-së nr. 641/15, datë 13.07.2015, ku në vend të gradës shkencore BA, të gjitha programet e akredituara sipas vendimit të cekur më sipër, përmirësohet në gradën shkencore BSc (Bachelor i Shkencave).
- III. Pjesa tjetër e vendimit mbetet e pa ndryshuara
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Duke u bazuar në nenin 108 të Ligjit mbi Procedurën Administrative, nr. 02/L-28, datë 22.07.2005, kërkesën e BPrAL Kolegji i Shkencave Mjekësore "Rezonanca" nr.34/16, datë 19.01.2016, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- BPrAL Kolegji i Shkencave Mjekësore "Rezonanca";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof Asoc. Dr. Blënim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

